

NË EMËR TË POPULLIT

P.nr.41/2017

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-Departamenti për Krime të Rënda (në Objektin e gjykatës në Vushtrri), Kryetari i trupit gjyqes Avni Mehmeti, procesmbajtësja Lale Miftari, në çështjen penale kundër të pandehurës [REDAKTUAR], për shkak të veprës penale; Keqpërdorimi i të drejtës së votimit nga nenin 216 par.1 pika 1.2 të KPRK-së, sipas akuzës se Prokurorisë Themelore në Mitrovicë PP.I.nr:186/2015, dt.08.03.2017. Pas mbajtjes dhe përfundimit të shqyrtimit fillestar, në prezencën e palëve; Prokurorit të Shtetit në PTH në Mitrovicë Ismet Ujkani, të pandehurës [REDAKTUAR], pas përfundimit të shqyrtimit fillestar, publik të regjistruar në procesverbal, me dt.19.05.2017, e ka shpallur publikisht aktgjykimin, ndërsa të njëjtën ditë me dt.19.05.2017, është përpiluar me shkrim ky:

AKTGJYKIM

Kundër të pandehurës:

[REDAKTUAR] nga i ati [REDAKTUAR], e ëma [REDAKTUAR], e vajzërisë [REDAKTUAR], e lindur me 14.05.1972 në Mitrovicë, me vendbanim në fshatin [REDAKTUAR], me nr. personal: [REDAKTUAR], serbe, Shtetase i Republikës së Kosovës dhe Serbisë, e martuar, nënë e dy fëmijëve, amvise, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së dobët ekonomike, me parë e pagjykuar ndaj saj nuk zhvillohet ndonjë procedurë tjetër penale, për këtë rast mbrohet në liri.

SHPALLET FAJTORE

Sepse:

Me dt.08.06.2014 në Qendrën e Votimit-Shtëpia e Kulturës në Leposaviq në zgjedhjet nacionale për Kuvendin e Kosovës, në numrin e vendvotimit [REDAKTUAR] ka votuar një herë si votuese me kusht, pastaj në kundërshtim me nenin 91 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë në Qendrën e Votimit në shkollën fillore "[REDAKTUAR]" në fshatin [REDAKTUAR] Komuna e [REDAKTUAR] në numrin e vendvotimit [REDAKTUAR] ka votuar edhe si votuese e rregullt.

-Me këtë ka kryer veprën penale: **Keqpërdorimi i të drejtës së votimit nga neni 216 par.1 pika 1.2 të Kodi Penal i Republikës së Kosovës (KPRK).**

Andaj gjykata në mbështetje të nenit 2 nenit 7,8,9,10,17,21,50,51,52,73,74 e nenit 216 të KPRK-ës, e lidhur me nenet 365, 366 të KPP-ës, të pandehurës [REDAKTUAR], i

SHQIPTON DENIM ME KUSHT

Ku i përcakton:

- I. **DENIM ME BURGIM - në kohëzgjatje prej / 6 /gjashtë / muaj /**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse e pandehura nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale të natyrës së njëjtë apo natyrës më të rëndë brenda një afati kohor prej /1/ një viti, nga koha e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në të kundërtën dënimi ekzekutohet.
- II. **OBLIGOHET** e pandehura [REDAKTUAR] të kompensoj shpenzimet e procedurës penale në shumën prej 20 euro si dhe shumën tjetër prej 20 Euro për paushallin gjyqësorë. Të gjitha këto obligohet t'i paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.
- III. Kërkesë pasurore juridike nuk pati.



Ar sy e t i m

Prokuroria Themelore në Mitrovicë, ka ngritur akuzë PP.I.nr:186/2015, dt.08.03.2017, ndaj të pandehurës [REDAKTUAR] për shkak të veprës penale: Keqpërdorimi i të drejtës së votimit nga nenin 216 par.1 pika 1.2 të KPRK-së.

Gjykata, për këtë lëndë penale në kuadër të kompetencës lëndore e territoriale, ka caktuar dhe ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me dt.19.05.2017, në të cilin kanë qenë të pranishëm Prokurori e shtetit në PTH-Mitrovicë Ismet Ujkani dhe e pandehura [REDAKTUAR].


E pandehura [REDAKTUAR], në shqyrtimin fillestar e ka pranuar në tërësi fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar; Keqpërdorimi i të drejtës së votimit nga neni 216 par.1 pika 1.2 të KPRK-së.

Gjykata, ka shqyrtuar pranimin e fajësisë të cilën e ka deklaruar e pandehura [REDAKTUAR] e në mbështetje të nenit 248 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), në këtë drejtim vlerëson se janë përmbushur kushtet ligjore për pranimin e fajësisë për të pandehurën. Gjykata, ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurës [REDAKTUAR] mbështetet në provat me të cilat disponon kjo gjykatë si: Nga zarfi i fletëvotimit me kusht në vendvotimin nr. [REDAKTUAR] në Leposaviq, ku shihet se ka votuar [REDAKTUAR], lista e votuesve me kusht në vendvotimin nr. nr.1201X/03D, në Leposaviq, ku shihet se [REDAKTUAR] e ka nënshkruar si votuese, si dhe lista e votuesve të rregullt nr:12/37 të cilën e ka nënshkruar [REDAKTUAR]. Të gjitha këto prova janë bindëse për gjykatën dhe formojnë elementin inkriminues e që në bazë e tyre dhe pranimin të fajësisë konsiderojmë se për tej çdo dyshimi është vërtetuar se e pandehura [REDAKTUAR] ka kryer veprën penale: Keqpërdorimi i të drejtës së votimit nga neni 216 par.1 pika 1.2 te KPRK-ës.

Gjykata, ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurës është bërë në mënyrë vullnetare, se e pandehura ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, duke iu tërhequr vërejtja të pandehurës se pas pranimin të fajësisë, ajo nuk mund të bëjë ankesë për shkak të konstatimit të gabuar të gjendjes faktike. Gjykata ka vërtetuar se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabim faktik, nga këto arsye gjykata e ka aprovuar pranimin e fajësisë të bërë nga e pandehura [REDAKTUAR].

Gjykata, nga pranimi i fajësisë prej të pandehurës dhe nga provat e cekura si më lart, ka vërtetuar përtej dyshimit të bazuar se e pandehura ka kryer veprën penale: **Keqpërdorimi i të drejtës së votimit nga neni 216 par.1 pika 1.2 te KPRK-ës.**

Gjykata, lidhur caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, për të pandehurën [REDAKTUAR] ka vlerësuar rrethanat për matjen e dënimit në mbështetje të nenit 73 të KPK-ës, e si rrethanë rënduese gjykata ka vlerësuar, dashjen e të pandehurës te kjo vepër penale, shkallën e përgjegjësisë penale të saj, kontributin esencial në këtë vepër penale, faktin se këto natyra të veprave penale kanë qenë shume të shprehura në Kosovë, faktin se këto vepra penale kanë ndikim negative tek qytetaret e Kosovës, krijojnë mosbesim në institucionet e shtetit, sepse siç dihet përmes rezultatit të votave zgjedhën përfaqësuesit e institucioneve të Kosovës. Ndërsa si rrethanë lehtësuese gjykata ka vlerësuar se, e pandehura ka pranuar fajësinë në tërësi për veprën penale, faktin se e njëjta ka shprehë keqardhje dhe është penduar për ndodhjen e rastit, duke premtuar se në të ardhëm nuk do të përsërisë sjelljet e njëjta, sjellja korrekte e të pandehurës në gjykatë, në raport me gjykatë dhe palët, faktin se e pandehura për herë të parë ka ra ndesh me ligjin, ndërsa ndaj tij nuk zhvillohet ndonjë procedure tjetër penale (kjo vërtetohet nga kauza ku ekziston një konstatim i tillë). Faktin se e pandehura është mbajtëse e vetme e familjes.



Gjykata, ka vërtetuar se e pandehura e kishte kryer këtë veprë penale që u shpall fajtores, mirëpo kjo gjykatë ka vërtetuar se tek kjo veprë penale ka munguar pasoja nga vepra penale, sepse nga kallëzimi penal i paraqitur ndaj të pandehurës nga Komisionit Qendror i Zgjedhjeve në Kosovë, vërtetohet se vota me kusht e të pandehurës [REDAKTUAR] është anuluar dhe nuk është numëruar, çka nënkupton se vota e saj me kusht nuk ka pasqyruar rezultatin e zgjedhjeve në Kosovë. Gjykata në veprimet e të pandehurës nuk ka gjetur ndonjë rrethanë posaçërisht rënduese, gjykata vlerëson se një dënim i tillë i shqiptuar ndaj të akuzuarës është adekuat dhe në jemi të bindur se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit i cili parashihet me ligj.

Lidhur me shpenzimet e procedurës gjykata vendimin e mori në bazë të nenit 450 të KPP-së.

Gjykata nga arsyet e cekura si më lartë e bazuar në nenin 365 të KPP-ës, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË

Departamenti për Krime të Rënda

P.nr.41/2017 i dt.19.05.2017

Procesmbajtësja:

Late Miftari

Kryetari i trupit gjykues-gjyqtari:

Avni Mehmeti



KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar e drejta në ankesë në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të aktgjykimit. Ankesa, i drejtohet gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate në kopje të mjaftueshme për gjykatën.

Republika e Kosovës  Republika Kosovo

SAKTËSINË E KOPJËS E VËRTETON
TAČNOST OTPRAVKA POTVRĐUJE



Punëtori i autorizuar
Ovlašćeni radnik

Sokolaj